

Udhëzimet për mbajtjen e raundit fizik të Ligës

Data e shpalljes: 15.02.2018

Këto udhëzime përbëhen nga pjesë të tekstit të Rregullave të Ligës “Kosova Makers” dhe interpretimit të tyre të detajuar në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i raundit të Ligës për të gjithë pjesëmarrësit. Udhëzimet janë hartuar në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve.

KU MBAHET RAUNDI I GARËS?

Për secilin raund garues të gjithë pjesëmarrësit e një rajoni mblidhen së bashku dhe mbajnë garën në të njëjtën kohë. Garat do të mbahen në BONEVET Prishtina ose BONEVET Gjakova, varësisht nga cili regjion janë pjesëmarrësit.

KUR MBAHET RAUNDI I GARËS DHE SA ZGJATË?

Raundi i garës mbahet gjatë ditëve të punës, në orët e pasdites dhe kohëzgjatja e raundit është afërsisht tre orë.

A DO TË MBAHEN TË GJITHA RAUNDET NË TË NJËJTIN VEND?

Të gjitha garat mbahen në qendrat e BONEVET Prishtina dhe BONEVET Gjakova.

A DUHET T’I PARAQESIM PJESËMARRËSIT PËR SECILIN RAUND?

Po, për secilin raund do t’i shpallim detyrat para raundit dhe formularin për paraqitjen e pjesëmarrësve. Në raundin e garës vijnë të gjithë garuesit e paraqitur së bashku me mentorët nga rajonet e caktuara.

KUSH I VLERËSON EKIPET NË GARË?

Gjatë mbajtjes së garës formohen komisionet vlerësuese në përbërje të dy mentorëve në mënyrë që mentorët të mos i vlerësojnë garuesit të cilët i kanë përgatitur për garë. Lista e komisioneve vlerësuese dhe pjesëmarrësve përkatës të cilët i vlerësojnë i dorëzohet organizatorit. Secili komision vlerësues vlerëson ekipe prej disa pjesëmarrësish në garë.

KUR DHE SI I MARRIN GARUESIT DETYRAT DHE TABELAT PËR VLERËSIM?

Para fillimit të garës secili komision vlerësues i merr detyrat e garës, tabelat për vlerësimin e garuesve (për përdorim personal) si dhe udhëzimet për vlerësimin e detyrave.

Në fillim të garës komisionet vlerësuese i shpërndajnë detyrat e garës - secilit garues nga një kopje, sipas grupmohës së ekipit. Tabelat për vlerësimin e ekipit garues vendosen paraprakisht në tavolinat e ekipeve garuese.

Detyrat e garës dhe tabela për vlerësim qëndrojnë në tavolinat e garuesve gjatë tërë garës.

Të gjitha komisionet vlerësuese marrin nga dy kopje të detyrave për garë, dy kopje të tabelave për vlerësimin e garuesve (për përdorim personal) si dhe dy kopje të udhëzimeve për vlerësimin e detyrave

dhe mënyrën e punës së komisionit vlerësues. Këto dokumente shërbejnë për punën e tyre dhe nuk u jepen garuesve.

KUR DHE SI VLERËSOHEN EKIPET?

Gjatë garës, pas përfundimit të fazave të caktuara të garës të cilat vlerësohen, komisioni vlerësues i shënon secilit garues pikët e fituara në tabelat e tyre për vlerësim. Komisioni vlerësues i njofton garuesit për pikët e fituara. Me rastin e vlerësimit të ekipeve, komisioni vlerësues duhet t'i përmbahet udhëzimeve për vlerësim dhe mënyrës së punës të komisionit vlerësues të cilat i pranojnë nga organizatori.

SI ORGANIZOHET GARA DHE VLERËSIMI NË RAST TË RAUNDIT GRUPOR?

Me rastin e raundit grupor, pjesëmarrësit në garë punojnë në një kompjuter me programin i cili e zgjidh detyrën e dhënë. Pikët e fituara nga raundi grupor i shtohen pikëve të pjesëmarrësit në rang listën e përgjithshme të sezonit, ndërsa garuesit individual e fitojnë një të katërtën e pikëve të fituara të ekipit. Në rast të pjesëmarrjes së ekipit prej më pak se 4 garues, nxënësit edhe në këtë rast e fitojnë një të katërtën e pikëve të ekipit.

A EKZISTON MUNDËSIA E ANKESËS NË REZULTATE?

Pas përfundimit të garës, mentorët kthehen tek ekipet e tyre dhe i kontrollojnë rezultatet së bashku me ekipin garues. Në rast të ankesës për pikët e fituara nga garuesi, mentori dhe komisioni vlerësues duhet ta zgjidhin ankesën në afat prej 15 minutash pas përfundimit të vlerësimit.

Pas përfundimit të garës dhe afatit për ankesa, komisionet vlerësuese i mbledhin tabelat e plotësuara për vlerësimin e ekipeve garuese dhe i'a dorëzojnë pjesëmarrësit në hapësirat e të cilit mbahet gara.

Pjesëmarrësi në hapësirat e të cilit mbahet gara është përgjegjës që brenda 24 orëve pas përfundimit të garës t'ia dorëzojë organizatorit rezultatet e garës sipas udhëzimeve për mënyrën e dorëzimit të rezultateve të garës.